

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Intercontinental link**

Neni 1 - Emri

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është Intercontinental link Shpk, më poshtë do të quhet "Shoqëria".

Neni 2 - Themelimi

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërët Tregtare" dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtare Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 3 - Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Bardhok Biba, Pall.75, Shk.4, Kati,1, Ap.69, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

Neni 4 - Ortaku i Vetëm

4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- Z. Endri Seiti, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 13.11.1986, mbajtës i letërnjoftimit nr. 038125671, me adresë në: Rr. Bardhok Biba, Pall.75, Shk.4, Kati,1, Ap.69, Tiranë, Tiranë.

Neni 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 6.360 (gjashtë mijë e treqind e gjashtedhjet) Euro, e konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të datës 21.07.2023 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në shumën 639.116 Lekë. Pra, kapitali themeltar i Shoqërisë është 639.116 (gjashtëqind e tridhjert e nenët mijë e njeqind e gjashtembedhjet) Lekë, qe përfaqësojnë 100% te kapitalit te Shoqërisë.

5.2 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës se shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjeter të parashikuar nga ligji.

Neni 6 - Objekti

6.1 Objekti i Shoqërisë është: agjenci private punësimi, brenda dhe jashtë Shqipërisë, që ofron, ndëmjetësim në tregun e punës, këshillim dhe orientim për punësim dhe zhvillim profesional, informacion për punëdhënësit mbi tregun e punës, shërbime të ofrimit të kandidatëve punëkërkues, informacion për programet e ndryshme të rekrutimit dhe burimeve njerëzore dhe çdo aktivitet tjeter sipas legjislacionit ne fuqi.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

ENDRI SEITI
FS.

Neni 7 - Kohëzgjatja

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 8 - Kompetencat e Ortakut të Vetëm

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

8.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen sipas rendit kronologjik në Regjistrin e Vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Vendimet e paregjistruara në këtë regjistër janë të pavlefshme. Administratori/ët e Shoqërisë janë përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Vendimeve.

Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë

9.1 Administratorët e parë të Shoqërisë janë:

a. Z. Endri Seiti, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 13.11.1986, mbajtës i letërnjoftimit nr. 038125671, me adresë në: Rr. Bardhok Biba, Pall.75, Shk.4, Kati,1, Ap.69, Tiranë.

9.2 Administratorët emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe do të qëndrojnë në detyrë për një afat 5 vjeçar. Administratorët mund të rizgjidhen për të njëjtin afat në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm ose në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor.

10.3 Ky Akt Themeli është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, më vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar sot më datë **21/07/2023**.

Z. Endri Seiti

ENDRI SEITI

Fs